UDHËZIM
Nr. 48, datë 6.9.2013

PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2013-2014 NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 32 të nenit 24 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2013-2014 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, të fillojë në datën 7 tetor 2013 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2014.

2. Viti akademik 2013-2014 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master shkencor/Master i arteve të bukura", të fillojë në datën 7 tetor 2013 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2014.

3. Viti akademik 2013-2014 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, të fillojë në datën 21 tetor 2013 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2014.

4. Periudha 24 dhjetor 2013 deri më 5 janar 2014, të jetë periudhë pushimesh për studentët.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtorinë e konvikteve, listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj